



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Data/nr	23.01.2024 <u>01-011/21-981</u>
Për:	Arbënesha Kuqi, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Gjakovës
CC:	- Të gjithë anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Gjakovës - Arkivit
Nga:	Ardian Gjini, Kryetar i Komunës së Gjakovës 
Lënda:	Propozim vendim për shfuqizimin e vendimit me nr. 01-011-29375 për Planin e Integritetit.

Të nderuar,

Duke u bazuar në nenin 58 shkronja (h) të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 53 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe nenin 46 shkronja (h) të Statutit të Komunës së Gjakovës të miratuar me datën 28.12.2022, Kryetari i Komunës së Gjakovës parashtrohet në Kuvendin e Komunës së Gjakovës këtë:

P R O P O Z I M V E N D I M

1. Kuvendi i Komunës së Gjakovës të miratojë vendimin për shfuqizimin e vendimit për Planin e Integritetit me numër 01-011-29375 të datës 28.12.2022.

2. Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit me datë 26.07.2023, ka nxjerr vendim për miratimin e metodologjisë për Planin e Integritetit i cili do të jetë uniformë për të gjitha organet e administratës qendrore, agjencitë e pavarura si dhe autoritetet komunale. Si rrjedhojë e kësaj, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit ka kërkuar nga Komunitat që plani aktual të shfuqizohet dhe të përditësohet konform nenit 25 të Ligjit për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit.

Me respekt!



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJAKOVËS

OPŠTINA DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Kuvendi i Komunës së Gjakovës

01 Nr. _____ /2022

Dt.28.12.2022

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 12 shkronja d të Ligjit 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, në mbledhjen e mbajtur me dt.28.12.2022, pas diskutimeve lidhur më pikën e 6-të të rendit të ditës: Shqyrtimi i Draft Planit të Integritetit për periudhën 2023 -2026, e miratoi këtë:

V E N D I M

Për

Planin e Integritetit për periudhën 2023 -2026

1. Miratohet Plani për Integritet për periudhën 2023 -2026 në Komunën e Gjakovës.
2. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është dokumenti i Plani për Integritet për periudhën 2023 -2026 për Komunën e Gjakovës.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës.
4. Vendimi iu dërgohet:
 - Kryetarit të Komunës së Gjakovës, z. Ardian Gjini.
 - Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal.
 - Drejtorive Komunale.
 - Shërbimit Profesional të Kuvendit të Komunës.
 - Arkivit.



Arbëneshha Kuqi

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës